

Dita botërore e luftës kundër kancerit

Kanceri është një term i përgjithshëm për një grup të madh të sëmundjeve, ka më shumë se 100 lloje të kancereve. Kanceri njihet edhe me terma të tjerë si tumore malinje dhe neoplazma. Kanceri është rritja e pakontrolluar e qelizave dhe përhapja e tyre, përtej kufijve të tyre të zakonshme, të cilat pastaj mund të pushtojnë pjesë të tjera të trupit dhe të përhapen në organe të tjera nëpërmjet sistemeve të qarkullimit të gjakut dhe limfatike. Kanceri mund të prekë pothuajse çdo pjesë të trupit.

Kanceri i prek të gjithë, të rinj dhe të vjetër, të pasur dhe të varfër, burra, gra dhe fëmijë, dhe paraqet një barrë të madhe për pacientët, familjet dhe shoqëritë.

Fakte nga bota

Kanceri është një nga shkaqet kryesore të vdekjes në botë, sidomos në vendet në zhvillim.

Kanceri është një shkak kryesor i vdekjes në mbarë botën dhe llogariten rreth 7.6 milion vdekje apo rreth 13% e të gjitha vdekjeve për vitin 2008.

Në mbarë botën, llojet kryesore apo më të zakonshme të kancerit që vrasin njerëzit janë: kanceri i mushkërive, stomakut, mëlçisë, i zorrës së trashë, i gjirit dhe kanceri i qafës së mitrës.

Llojet më të shpeshta të kancerit ndryshojnë midis burrave dhe grave.

Në shumë vende në zhvillim, kanceri i qafës së mitrës është kanceri më i zakonshëm.

Rreth 70% e të gjitha vdekjeve nga kanceri ndodhin në vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme. Vdekjet nga kanceri në mbarë botën janë parashikuar të vazhdojnë të rriten në mbi 13.1 milion në vitin 2030.

Rreth 30% e vdekjeve nga kanceri ndodhin për shkak të rreziqeve kryesore të mënyrës së jetesës dhe sjelljes, si: mbipeshja e obeziteti, konsumimi i pakët i frutave e perimeve, mungesa e aktivitetit fizik, përdorimi i duhanit, përdorimi i tepruar i alkoolit.

Përdorimi i duhanit është faktori më i rëndësishëm i rrezikut për shkaktimin e kancerit; shkakton 22% të vdekjeve në tërësi nga kanceri dhe 71% të vdekjeve nga kanceri i mushkërive.

Një e pesta e të gjithë kancereve në mbarë botën janë të shkaktuara nga një infeksion kronik, për shembull virusi i papillomës njerëzore (HPV) shkakton kancerin e qafës së mitrës dhe virusi i hepatitit B (HBV) shkakton kancerin e mëlçisë. Kanceri i shkaktuar nga infeksione virale të tilla si virusi i hepatitit B e C dhe virusi i papillomës njerëzore janë përgjegjës për deri në 20% të vdekjeve nga kanceri në vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme.

Rreth 70% e të gjitha vdekjeve nga kanceri në vitin 2008 kanë ndodhur në vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme. Vdekjet nga kanceri në mbarë botën mendohet se do të vazhdojnë të rriten, dhe vlerësohet se në vitin 2030 do të ketë 13.1 milion vdekje.

Fakte nga vendi ynë

Në vendin tonë, si në shumë vende të tjera të botës, kanceri vazhdon të jetë një problem i shëndetit publik.

Kemi afërsisht 3500 raste të reja të kancerit çdo vit, sipas rregjistrit të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, por duhet theksuar se në vendin tonë kanceri kapet në faza të avancuara.

Sipas INSTAT: Vdekjet nga Tumoret zënë vendin e dytë në strukturën e vdekshmërisë së përgjithshme me 16%, dhe format më të shpeshta janë tumoret malinj të aparatit tretës, të frymëmarrjes dhe urogenitale.

Gjithashtu 87.8% e vdekjeve nga tumoret janë mbi moshën 50 vjeç.

Tumoret malinj të aparatit tretës janë 2 herë më shumë tek meshkujt se tek femrat dhe zënë 32% të vdekshmërisë mbrenda grupit të tumoreve.

Tumoret malinj të aparatit të frymëmarrjes janë 4 herë më shumë tek meshkujt se tek femrat.

Tumoret malinj të gjirit janë 4 herë më shumë tek femrat se tek meshkujt.

Tumoret malinj të organeve urogenitale janë 1.6 herë më shumë tek meshkujt se tek femrat.

Vdekjet nga tumoret në fshat zënë 46% .

Faktorët risk

Faktorët kryesorë të rrezikut që kontribuojnë në zhvillimin e kancerit në mbarë botën janë:

Përdorimi i duhanit; Përdorimi i alkoolit; Dietat jo të shëndetëshme, pasiviteti fizik. Infeksionet kronike nga hepatiti B (HBV), hepatiti C (HCV virus) dhe disa lloje të Virusit të Papillomës Humane (HPV) janë faktorët kryesorë të rrezikut për kancerin në vendet me të ardhura ulëta dhe të mesme.

Faktorët gjenetik të një personi janë faktorë rreziku; disa agjentë të jashtëm, si Karcinogjenët fizikë, (rrezatimi ultraviolet dhe jonizues); Karcinogjenët kimikë, (azbest, përbërësit e tymit të duhanit, aflatoxin, dhe arseniku; Karcinogjenët biologjikë, si infeksionet nga viruset, bakteret ose parazitëve të caktuar .

Moshimi është një tjetër faktor themelor për zhvillimin e kancerit. Incidenca e kancerit rritet me rritjen e moshës, probabilitet për shkak të shtimit të rreziqeve për rritjen e kancereve të caktuara që rriten me moshën.

Ndryshimet dhe shmangia e faktorëve të rrezikut

Më shumë se 30% e vdekjeve nga kanceri mund të parandalohen duke ndryshuar apo shmangur faktorët kryesorë të rrezikut, duke përfshirë: Përdorimin e duhanit; Të qenit mbipeshë apo obez; Dietat jo të shëndetëshme dhe konsumin e ulët me fruta dhe perime;

Mungesën e aktivitetit fizik;Përdorimin e alkoolit;Infeksionin -HPV seksualisht të transmetueshëm; Ndotjen urbane të ajrit;Tymi brenda shtëpisë nga përdorimi shtëpiak i lëndëve djegëse të ngurta.

Barra e kancerit mund të reduktohet duke rritur njohuritë mbi shkaqet e kancerit, si dhe ndërhyrjet për të parandaluar dhe për të menaxhuar këtë sëmundje që është gjithëpërfshirëse. Kanceri mund të reduktohet dhe kontrollohet nga zbatimi i strategjive të bazuara në prova për parandalimin e kancerit, zbulimin e hershëm të tij dhe menaxhimin e pacientëve me kancer. Shumë kancere kanë një shans të lartë të shërimit, nëse zbulohen herët dhe të trajtohen në mënyrën e duhur.

Kostua ekonomike e kancerit në mbarë botën është vlerësuar 485 bilion dollar në vit dhe mendohet se do të rritet.

Strategji parandaluese ndaj kancerit janë:shmangia sa më shumë e faktorëve të rrezikut të listuar më sipër;vaksinimi kundër virusit papilloma të njeriut (HPV),virusit të hepatitit B (HBV);mbajtja nën kontroll e rreziqeve profesionale si dhe reduktimi i ekspozimit ndaj rrezeve të diellit.

Zbulimi i hershëm i kancerit mund të reduktojë vdekshmërinë nga kanceri. Për zbulimin e hershëm dy janë komponentet kryesore:

1.Diagnoza e hershme.Informimi mbi shenjat e hershme dhe simptomat (për disa lloje të kancerit si kanceri i qafës së mitrës,të gjirit, kolorektal dhe gojës) në mënyrë që të diagnostikohen dhe trajtohen herët, para se sëmundja të avancojë.

2.Depistimi .Ekzaminimi është përcaktuar si aplikimi sistematik i një testi në një popullsi asimptomatike. Ai synon për të identifikuar individë me anomalitë për kancer të veçantë ose anomali para-kanceroze dhe i referohen ata menjëherë për diagnozë dhe trajtim.

Shembuj të metodave ekzaminuese janë:

Inspektim vizual me acid acetik (VIA) për kancerin e qafës së mitrës për vendet me të ardhura të ulta;
PAP testi për kancerin e qafës së mitrës në vendet me të ardhura të mesme dhe të larta;
Ekzaminimi klinik i gjirit nga profesionistë të shëndetit
Mamografia për kancerin e gjirit në vendet me të ardhura të larta.

Dita Botërore kundër Kancerit është një nismë e Unionit Ndërkombëtar për Kontrollin e Kancerit(UICC),e mbështetur nga Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe Agjensia Ndërkombëtare për Kërkime mbi Kancerit (IARC) dhe synohet për të ndihmuar e shpëtuar miliona vdekje të parandalueshme çdo vit duke rritur ndërgjegjësimin dhe edukimin në lidhje me kancerin, dhe të ushtrohet presion mbi qeveritë dhe individët në mbarë botën për të ndërmarrë veprime kundër sëmundjes.

Dita Botërore e kancerit zhvillohet çdo vit më 4 shkurt dhe është nisma e vetme, ku e gjithë bota mund të bashkohet së bashku në luftën kundër epidemisë globale të kancerit me fokuse të ndryshme çdo vit.

Fokusi i Ditës Botërore kundër Kancerit për vitin 2013, është zgjedhur objektivi i 5 i Deklaratës Botërore të Kancerit për të larguar mitet dhe keqkuptimet e dëmshme rreth kancerit, është zgjedhur mesazhi "Kanceri - A e dini se?".

"Kanceri - A e dini se?"

Miti 1: Kanceri është vetëm një çështje e shëndetit

E vërteta:Kanceri nuk është vetëm një çështje e shëndetit. Ajo ka shtrirje të gjerë sociale,ekonomike, e zhvillimit, dhe implikimeve të të drejtave të njeriut.kanceri sjell varfëri,impakt negativ në familje dhe komunitet.

Miti 2: Kanceri është një sëmundje e vendeve të pasura, të moshuara dhe të zhvilluara

E vërteta: Kanceri nuk diskriminon. Kanceri është një epidemi globale, prek të gjitha moshat, të gjitha grupet sociaie sjell një barrë joproporcionale për vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme.50% e kancereve ndodhin në moshat nënë 65 vjeç

Miti 3: Kanceri është një dënim me vdekje

E vërteta : Shumë kancere që janë konsideruar dikur një dënim me vdekje tani mund të shërohen dhe për shumë njerëz kanceri i tyre tani mund të trajtohet në mënyrë efektive. Me pak përjashtime, kanceret e hershme fazë janë më pak vdekjeprurëse dhe më të shërueshme se kanceret fazë vonë.

Kjo është një keqkuptim të përbashkët që zgjidhjet e kancerit janë shumë komplekse dhe të shtrenjta për vendet në zhvillim

Miti 4: Kanceri është fati im

E vërteta: Me strategji të duhura, të drejta më shumë se një në çdo tre kancere apo 30% e tyre mund të parandalohen.

Për më shumë informacion kërkoni në adresat e mëposhtëme:

- www.who.int/topics/cancer/
- www.iarc.fr
- www.uicc.org
- www.cancer.gov
- [www.Instat.gov.al\(shkaqet e e vdekjeve për vitin 2009\)](http://www.Instat.gov.al/shkaqet_e_e_vdekjeve_për_vitin_2009)
- www.worldcancerday.org/cancer-myths

Përgatiti:

Jeta Lakrori

Departamenti i Promocionit